

**V E N D I M
P Ë R**

**MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION PËR NDËRTIM LANDFILLI E INCENERATORI DHE
REHABILITIM TË VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 25, të ligjit nr.125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e bonusit prej 8 (tetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë "Integrated Energy B.V.", sh.p.k., për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese të Tiranës.
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I
E D I R A M A**

